



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:226664
Datë: 17.12.2024
Numri i dokumentit: 06611926

CAP.nr.1841/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren Nora Bllaca Dula, në çështjen përmbartimore të të kreditorit E.I nga Gj..... të cilin e përfaqëson avokati K.B nga Gj....., kundër debitorit Komuna e Novobërdës-D..... lidhur me propozimin për përmbartim në bazë të aktgjykimit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Novobërdë, CPK.nr.31/2024, të datës 06.09.2024, me datë 16.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit të përmbartimit Komuna e Novobërdës-DKA, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Novobërdë, CPK.nr.31/2024, të datës 06.09.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Novobërdë, CPK.nr.31/2024, të datës 06.09.2024, ka vendosur si në vijim: “I. Refuzohet si i pa bazuar prapsimi i datës 02.08.2024, i debitorit Komuna e Novobërdës-DKA kundër Urdhërit Përmbartimor P.nr.2166/24, të datës 22.07.2024, të përmbartusit privat B.N nga Gj.....

II. Mbetet në fuqi Urdhri Përmbartimor i Përmbartuesit Privat, B.N nga Gj....., P.nr.2166/24, të datës 22.07.2024

III. Obligohet debitori që të paguaj shumën prej 156.00 euro, për përpilim e përgjigjes në prapësim”.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, duke mos theksuar shkaqet e parapara me dispozitat e LPK-së, me propozim drejtuar Gjykatës së Apelit, që të aprovohet ankesa e debitorit si e bazuar, të pezullohet aktvendimi i shkallës së parë me të cilën është refuzuar prapësimi i debitorit.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka parashtruar propozim për përbarim me datën 22.07.2024, ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përbarimor Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan-Dega në Novobërdë, C.nr.52/20 i datës 01.12.2020 i plotfuqishëm me datë 26.10.2022, i ekzekutueshëm i datës 15.04.2024, duke e detyruar debitorin që kreditorit t'ua kompensojë në shumën prej 2.380 € të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë së datës 14.04.2020 në afat prej 7 ditësh e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës.

Përbaruesi Privat, privat B.N nga Gj..... me Urdhrin Përbarimor P....., të datës 22.07.2024, e ka lejuar propozimin për përbarim në këtë çështje përbarimore.

Debitori me dt. 02.08.2024, ka ushtruar prapësim duke e kundërshtuar propozimin e kreditorit për përbarim , duke theksuar se propozimi për përbarim nuk është i bazuar në dispozita ligjore dhe se i njëjti nuk përmban në vete dokumentin përbarimor sipas nenit 22 dhe 29 të LPK-së, e i cili parasheh dokumentet përbarimore mbi të cilat bazohet propozimi për përbarim . Gjykatës i ka propozuar ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe ta shfuqizoj urdhrin përbarimor P.nr.2166/24, të datës 22.07.2024.

Përfaqësuesi i kreditorit me dt. 07.08.2024, ka ushtruar përgjigje ne prapësim duke shtuar se propozimi për përbarim bazohet në aktgjykimin Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan – Dega në Novobërdë me shenjën C.nr.52/20 i dt. 01.12.2020, i cili është bërë i plotfuqishëm dhe i me dt.26.10.2023 dhe i ekzekutueshëm me dt.15.04.2024, i cili është dokument përbarimor sipas nenit 22 paragrafi 1 të LPP-së .Prapësimi i ushtruar nuk është i plot në vete nuk përmban asnjë dokument mbi të cilin mund bazohet, por vetëm është ushtruar për të prolonguar ekzekutimin ku debitori ka për obligim ti përmbush kërkesat e kreditorit të cilat janë të ligjshme dhe të arsyeshme, gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin dhe ta lë në fuqi urdhrin përbarimor P.nr.2166/24, të datës 22.07.2024.

Gjykata Themelore në Gjiilan-Dega në Novobërdë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit ka nxjerrë aktvendimin CPK.nr.31/24, të datës 06.09.2024, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të papabuar prapësimin e debitorit duke vendosur si në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se pas vlerësimit të prapësimit të debitorit gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për arsye se pretendimet nuk hyjnë në shkaqet e parapare nga neni 71 i LPP-së, e të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përbarimin e lejuar, duke shtuar se dokumenti mbi të cilin është mbështetur urdhri mbi lejimin e përbarimit ka titull ekzekutiv dhe se nuk përmban asnjë nga shkaqet e parapara nga neni 71 par 1 nën par 1.1 – 1.12 të LPP –së, po ashtu debitori pretendimet e tij nuk i ka mbështetur në prova siç parashihet në nenin 69 par 4 të LPP –së. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se urdhri përbarimor P.nr.230/23 i datës 20.07.2023, me të cilin është lejuar përbarimin, është lëshuar në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë me shenjën C.nr.52/20 i dt. 01.12.2020, i cili është bërë i plotfuqishëm dhe i me dt.26.10.2023 dhe i ekzekutueshëm me dt.15.04.2024 me këtë aktgjykim tani debitori është detyruar që kreditorit t’iu kompensojë shujtat ditore si në vendimin e lartcekur.

Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se aktgjykimi në fjalë në bazë të të cilit edhe është lejuar përbarimi është dokument përbarues, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga nenet: 21, 22 paragrafi 1 pika 1, 23 paragrafi 1, 24 paragrafi 1 si dhe 27 paragrafi 1 të LPP-së, për të qenë i përbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përbarim.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit të parë lidhur me atë se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përbarimore, për faktin se në rastin konkret dokumenti përbarues në bazë të cilit është lejuar përbarimi është Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Themelore në Gjilan – Dega në Novobërdë me shenjën C.nr.52/20 i dt. 01.12.2020, i cili është bërë i plotfuqishëm dhe i me dt.26.10.2023 dhe i ekzekutueshëm me dt.15.04.2024 e cila në rastin konkret është dokument përbarues, e kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se: “*dokument përbarimor është vendimi përbarues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përbaruese*” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: “*dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje dhe interpretim të gabuar të dispozitave të LPP-së, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës

dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Pretendimet e debitorit për shkelje të dispozitave të procedurës përbarimore nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, sepse në procedurën përbarimore gjykata me rastin e vendosjes për prapësimin vendos duke ju përmbajtur parimit të rigorozitetit formal-juridik që nënkupton se gjykata do të vlerësoj shkaqet për prapësim por nuk mund të lëshohet në vlerësimet tjera, pasi që këto pretendime kanë mundur të paraqiten në kohën kur është marrë dokumenti përbarues.

Nuk janë pranuar as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata përbarimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi përfshirë edhe kushtet formale nga të cilat varet lejueshmëria e përbarimit.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarja individuale në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së (i cili është në fuqi aktualisht, me numër 04 L-139), me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1841/2024, me datë 16.12.2024

Gjyqtarja
Nora Bllaca Dula, d.v